



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.100/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Bahceci Healthcare” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë & Kirurgji, me seli në Prishtinë Magjistratja Prishtinë –Shkup, me themelues Dr. A.B., i përfaqësuar nga Firma “Kërveshi & Parnters” SH.P.K., me seli në Rr “B”, Mati 1, Hyrja C15/10 Nr.2, Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit nr. Prot. 05-4250 i datës 08.08.2019 dhe me nr.10/K-014/2019 dhe vendimin Nr. Ref./Aj-019-19 i datës 03.06.2019 i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publik më datë 29.01.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit sipas autorizimit Avokat G.S., dhe me pjesëmarrje të përfaqësueses të autorizuar ta palës së paditur N.K., më datë 29.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Bahceci Healthcare” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë & Kirurgji, me seli në Prishtinë kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimit të Vendimit nr. Prot. 05-4250 të datës 08.08.2019 dhe me nr.10/K-014/2019 dhe vendimin Nr. Ref./Aj-019-19 i datës 03.06.2019 të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me propozim që të obligohet e paditura që paditësit ti kthejë shumën në lartësi prej 20,000.00 euro për pagesën e gjobës së shqiptuar, me kamatë ligjore prej 8% në vite, nga data e pagesës së gjobës e deri në pagesën definitive dhe të obligohet e paditura që paditësve t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar material lidhur me fitimin e humbur me rastin e ekzekutimit të aktit administrativ, për ndalim të ushtrimit të veprimtarisë

shëndetësore për shërbimin IVF, së bashku me kamatë në lartësi prej 8%, **si e pa bazuar**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 16.09.2019, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “Bahceci Healthcare” -Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë & Kirurgji, me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit nr. Prot. 05-4250 i datës 08.08.2019 dhe me nr.10/K-014/2019, i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Inspektorati Shëndetësorë, me propozim që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit “Bahceci Healthcare” -Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë & Kirurgji dhe Dr. A.B., themelues i IPSG “Bahceci Health Care”, dhe të anuloj vendimin e Inspektoratit Shëndetësor Nr. 10/K-014-2019 i datës 07.08.2019 dhe vendimin i Inspektoratit Shëndetësor Nr.Ref./Aj-019-19 i datës 03.06.2019, si i kundërligjshëm, të obligohet e paditura që paditësit ti kthejë shumën në lartësi prej 20,000.00 euro për pagesën e gjobës së shqiptuar, me kamatë ligjore prej 8% në vite, nga data e pagesës së gjobës e deri në pagesën definitive. Obligohet e paditura që paditësve t’ia kompensoj dëmin e shkaktar material lidhur me fitimin e humbur me rastin e ekzekutimit të aktit administrativ, për ndalim të ushtrimit të veprimtarisë shëndetësore për shërbimin IVF, së bashku me kamatë në lartësi prej 8%. Lënda është evidentuar me nr. A.nr. 2159/19,
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 100/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesorë dhe publik më datë 23.01.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit Avokat G.S., sipas autorizimit të datës

01.06.2023, dhe përfaqësueses së palës së paditur N.K., sipas autorizimit nga avokatura shtetërore, ndërsa më datë 29.01.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit, ndërsa konform nenit 41 të LKA-së në mungesë përfaqësuesit të palës së paditur, gjykata ka konstatuar se ka pranuar një parashtrësë të datës 24.01.2024 nga e paditura për deklaram për seancë dhe ka propozuar që seanca të mbahet pa prezencën e palës së paditur.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga vendimi i goditur me padi, institucionit privat shëndetësor i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë shëndetësor për shërbim të IVF, ndëshkohet me gjobë në vlerë prej 20,000.00 euro, vendim përsërit një pjesë të konstatimeve të shkallës së parë, i bazuar në dispozita të pa qena që rregullojnë procedurën në fjalë, nuk i referohet asnjë dispozitë konkrete, as të ligjve të cituara e as udhëzimit administrativ UA 06/20163, duke rezultuar se vendimi i goditur me padi ka mungesë paqartësie juridike. Znj. N.K. është Ushtruese e Detyrës (UD), e Kryeinspektorës që e ka shpallur vendimin e shkallës së dytë dhe e njëjta ka inspektuar këtë institucion dhe ka vendosur në shkallë të parë. Vendimi nuk është i qartë se mbi cilin raport apo raporte dhe cilat dispozita saktësisht të ligjit udhëzimit administrativ apo ndonjë normë tjetër në fuqi në Kosovë janë shkelur ga ankuesi.
5. Ka deklaruar se, nga UA 06/2013 një sanksion komulativ parashihet për shkeljen e nenit 5 të UA 06/2013, mirëpo në arsyetimin e vendimit nuk theksohet se ankuesi ka shkelur nenin 5 të UA 06/2013, andaj vendimi mbi shqiptimin e sanksionit nuk është i ligjshëm, i cili nuk parashihet në UA 06/2013. Shkalla e dytë nuk e ka eliminuar kontradiktorialitetin në mes të arsyetimit dhe dispozitivit të vendimit shkallës së parë. Në arsyetim theksohet se janë gjetur dëshmi se nga një donatore janë dhënë qeliza më shumë se një pranuese (2-7), ndërsa sipas inspektoratit kjo është e ndaluar, konstatim i pa mbështetur në ndonjë ligj në fuqi. UA 06/2013 në nenin 24 citon se “ Qelizat gjinore të dhuruara nga një person, shfrytëzohen deri në lindjen e më së shumti tre fëmijëve të gjallë”. Këtij konstatimi të gabuar nga shkalla e parë, shkalla e dytë nuk i referohet fare në arsyetim se përse qenka e ndaluar ajo që është e lejuar në nenin 24

të UA 06/2013. Vendimi i te paditurës është ne kundërshtim me nenin 48 par.1 pika 1.4 dhe par.2. te LPA-së me qenëse vendimi i mungon arsyetimi i cili do duhej te përmbante edhe bazën ligjore te vendimit dhe arsyen se pse është e zbatueshme ne rastin konkret, arsyetim i paqarte kundërthënës e për me tepër te pakuptueshëm, e qe konsiderojmë se ky vendim është i barabarte me mungesën e arsyetimit te tij, çka është ne kundërshtim me nenin 52,92, dhe 85 te LPA-së.

6. Ka theksuar se, Inspektorati shëndetësor, gjatë viteve parapake ka kryer inspektime të rregullta të paditësit ku gjatë çdo inspektimi ka ofruar rekomandimet e veta, por asnjëherë nuk është njoftuar apo informuar se në lidhje me procedurën e IVF-së duhet ndjekur ndonjë standard tjetër, duhet të zhvilloj tjetër procedurë apo duhet ndërmarrë ndonjë veprim të saktësuar në rekomandime të cilat ankuesi pas këtyre inspektimeve nuk i ka bërë. Revokimi i licencës është masë më e rëndë e cila mund ti shqiptohet një institucioni privat shëndetësorë, pa marr kohëzgjatjen e kësaj mase dhe revokimin nuk mund ta bëj inspektorati, por bordi e që në rastin konkret ka vendosur inspektorati përkundër që vet ky institucion i sugjeron bordit për të vendosur. Vendimi i kundërshtuar me padi ka për pasoj, mbylljen e një biznesi privat, në të cilin kanë gjetur vend të rregullt të punës rreth 100 punëmarrës vendor. Nga koha e inspektimi biznesi ka rreth 100,000.00 euro humbje dhe revokimi i licencës i pamundëson paditësve që të operojnë në realizimin e punëve të tyre. Përmes parashtresës së datës 23.01.2024, paditësi ka bërë precizimin e kërkesë padisë, duke i propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit “Bahceci Healthcare” -Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë & Kirurgji dhe Dr. A.B., themelues i IPSEG “Bahceci Health Care”, dhe të anuloj vendimin e Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/K-014-2019 i datës 07.08.2019 dhe vendimin i Inspektoratit Shëndetësor Nr.Ref./Aj-019-19 i datës 03.06.2019, si i kundërligjshëm, të obligohet e paditura që paditësit ti kthejë shumën në lartësi prej 20,000.00 euro për pagesën e gjobës së shqiptuar, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e pagesës së gjobës e deri në pagesën definitive. Obligohet e paditura që paditësve t’ia kompensoj dëmin e shkaktar material lidhur me fitimin e humbur me rastin e ekzekutimit të aktit administrativ, për ndalim të ushtrimit të veprimtarisë shëndetësore për shërbimin IVF, së bashku me kamatë në lartësi prej 8%.

Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi i të paditurës, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe publik të datës 23.01.2024, ka deklaruar se e kundërshtonë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj, vendimi i të paditurës është në pajtim me legjislacionin në fuqi, kundërshtonë propozimin e paditësit për caktimin e ekspertit financiar, njoftoj gjykatën se lidhur me afatshmërinë e ushtrimit të padisë, dëshminë mbi pranimin e vendimit e njëjta mungon në shkresat e lendes, por vlerësojnë se kërkesëpadia e paditësit është e pasafatshme dhe deri me tani nuk kanë dëshmi mbi ekspedimin për dorëzimin e vendimit të paditësit.

Provat e administruara

8. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi me nr.10/K -014-2019 i datës 07.08.2019, Vendimi me nr.K-008/2019 i datës 12.07.2019, Vendimi me nr.10/AJ-019/19 i datës 03.06.2019, Pagesë e faturave për pagesë të gjobës, Aktvendim për pushim të hetimeve PPS.98./20 nr.0038672 Me datë 15.09.2021, Vendim nga MSH me datë 19.04.2012 me nr.02/2012, Vendim nga MSH me datë 23.04.2013 me nr.02/2012-2, Licencë nga MSH për paditësin Bahceci me nr. të licencës 02/2012, Raporti i inspektimit me nr.prot:05-2871 i datës 03.06.2019, Procesverbal mbi inspektimin e bërë me nr.006310, Procesverbal mbi inspektimin e bërë me nr.006311, Procesverbal mbi inspektimin e bërë me nr.006312, Procesverbal mbi inspektimin e bërë me nr.006314
9. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

10. Spital special për gjinekologji, infertilitet dhe endokrinologji “Bahceci” është pajisur nga Ministria e Shëndetësisë me licencë më datë 19.04.2012, me nr. të licencës 02/2012.
11. Me Vendim nga Ministria e shëndetësisë (MSH) me datë 19.04.2012 me nr.02/2012, Spitalit special për gjinekologji, infertilitet dhe endokrinologji “Bahceci”, lejohet kryerja e të gjitha shërbimeve shëndetësore, në bazë të Ligjit për Shëndetin Riprodhues.
12. Me Vendim nga MSH me datë 23.04.2013 me nr.02/2012-2, Spitalit special për gjinekologji, infertilitet dhe endokrinologji “Bahceci”, lejohet kryerja e të gjitha shërbimeve shëndetësore, në bazë të Ligjit për Shëndetin Riprodhues. Plotësohet vendimi nr. 02.2012 i datës 19.04.2012, duke i shtuar edhe njësinë përbërëse Shërbimi i Kirurgjisë.
13. Sipas Raportit të inspektimit me nr.prot:05-2871 i datës 03.06.2019, Ministria e Shëndetësisë Inspektorati Shëndetësorë më datë 03.06.20199 ka bërë raport inspektimi i planifikuar në IPSH “Bahceci” Health Care” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë & Kirurgji, Prishtinë. Qëllimi i inspektimit ishte verifikimi i normave ligjore, etike dhe standarde të cilësisë, punës së mjekëve të huaj në këtë institucion e veçanërisht mbarëvajtjen e punës në shërbimin e frytnimit të asistuar mjekësor IVF. U kontrolluan dosjet e pacienteve te cilët kane kryer proceduar te IVE-it me nr. te dosjes DR 30, YD1, YD9, YD5, ne te cilat mungonin: numri total i embrioneve te përfituara me numrin e embrione te transferuar, te ngrire dhe te asgjësuar te paciententit, pelqimi i psikologut, pelqimi i Juristit, nenshkrimi i mjekut. U kontrolluan dosjes e dhuruesve me nr të. dosjes DNR 30, YD1,YD9,YD5, DNR6 ku u konstatua që nuk janë te evidentuar kujt i janë dhuruar embrionet. Ne dosjen e pacientit me nr. YD5 është bërë tërheqja e 110 qelizave ne total nga te cilat 15 janë transferuar mirëpo nuk ka asnjë shenim se ku janë dhuruar keto qeliza tjera, dokumentimi i embrioneve deri ne destinacionin e fundit mungon. Pacientja me nr. te dosjes YD5 ne afat kohor prej 6 muajve ka dhuruar 3 here qeliza gjinore me date: 20.03.2017, 26.05.2017 dhe 22.09.2017. Ne baze te Nenit 20 paragrafi 3 te UA 06/2013 citoj: (ndersa është gjetur ne dosjen e pacientit me nr. YD 9, DNR 56, 48-31

qe nga një dhurues jane transferuar qelizat gjinore ne 2-7 femra e qe 4 prej tyre jane shtatezane ne te njejten kohe). Neni 24 paragrafi 3 i UA 06/2013 obligon institucionin shëndetësor që para dhurimit te fekondimit heterolog te kërkoje verifikimin ne regjistrin zyrtar për shfrytëzimin e qelizave gjinore te dhuruara te cilat duhet te jene ne pajtim me paragrafin 1 dhe 2. Ne dosje te pacientit YD5 ,DNRS28 qëndron se kanë qenë dhurues edhe me herët në IPSH "Lindja", IPSH "Fati im" , IPSH. Prandaj nga kjo u konstatua që qelizat e dhuruesit janë përdor-transferuar në 2-7 femra e jo vetëm në një pacient, siç është e paraparë me UA 06/2013, mungon verifikimi në regjistrin zyrtar për shfrytëzimin e qelizave gjinore të dhuruara në institucionet tjera ku pacientët kanë dhuruar, mungon numri total i embrioneve në dosjet e pacientëve të përfituara me numrin e embrioneve të transferuar të ngrirë dhe të asgjësuar të pacientit, pëlqimi i psikologut, pëlqimi i juristit, nënshkrimi i mjekut, mungon regjistri i posaçëm për donator, mungon sistemi i kodimit unik nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas, dyshohet se është bërë kompensimi për dhurim të qelizave, dosja e pacientëve të dhuruesve nuk plotësohet me të gjitha të dhënat, mungojnë analizat e obliguara për sëmundjet ngjitëse, anamneza e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut më vulë, përdoret gjuha turke në dosjet e pacientëve dhe vazhdimisht reklamim të FAM-it në rrjetet sociale facebook. Janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 11 par.1 nën par.1.3. dhe 1.4, neni 15 par.1.3., neni 19 par1, neni 20 par.3, 31 par. 1 dhe 2, neni 43, neni 24par.3, neni 52 par 1 dhe 2 të UA nr. 06/2013 për frytnimin e asistuar Mjekësisë. Raporti u bazua në Procesverbal mbi inspektimin e bërë me nr. 006310, nr.006311, nr.006312, nr.006314, më datë 16.05.2019 në laboratorin e endrikologjisë, ku janë kontrolluar dosjet e pacientëve dhe janë dhënë konstatimet nga inspektorët.

14. Me Vendim me nr.10/K -014-2019 i datës 07.08.2019, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati shëndetësor, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me nr. prot. 05-2872/2 të datës 14.06.2019 dhe ka lënë në fuqi vendimin me nr. 05-2872 të datës 03.06.2019 të Inspektoratit shëndetësor, me arsyetim se kryeinspektori kryesor pasi që i ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës si dhe dispozitat ligjore përkatëse, ka konstatuar se IPSH "Bahceci Healthcare" Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë & Kirurgji, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, qelizat e dhuruesit janë përdorur-transferuar ë 2-7 ferma e jo vetëm në një pacient, siç është e paraparë me

UA 06/2013, mungon verifikimi në regjistrin zyrtar për shfrytëzimin e qelizave gjinore të dhuruara në institucionet tjera ku pacientët kanë dhuruar, mungon numri total i embrioneve në dosjet e pacientëve të përfituara me numrin e embrioneve të transferuar të ngrirë dhe të asgjësuar të pacientit, pëlqimi i psikologut, pëlqimi i juristit, nënshkrimi i mjekut, mungon regjistri i posaçëm për donator, mungon sistemi i kodimit unik nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas, dyshohet se është bërë kompensimi për dhurim të qelizave, dosja e pacientëve të dhuruesve nuk plotësohet me të gjitha të dhënat, mungojnë analizat e obliguara për sëmundjet ngjitëse, anamneza e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut më vulë, përdoret gjuha turke në dosjet e pacientëve dhe vazhdimisht reklamim të FAM-it në rrjetet sociale facebook. Janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 11 par.1 nën par.1.3. dhe 1.4, neni 15 par.1.3., neni 19 par1, neni 20 par.3, 31 par. 1 dhe 2, neni 43, neni 24par.3, neni 52 par 1 dhe 2 të UA nr. 06/2013 për frytnimin e asistuar Mjekësore.

15. Me Vendim me nr.K-008/2019 i datës 12.07.2019, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati shëndetësor, ka shtyrë afatin për vendosje në shkallë të dytë ndaj ankesës me nr. prot. 05-2872/2 e datës 14.06.2019, me arsyetim se nevojitet kohë shtesë për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative.

16. Nga Vendimi me nr.10/AJ-019/19 i datës 03.06.2019, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati shëndetësor, ka marr vendim duke i ndaluar “ Bahceci Healthcare” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrike & Kirurgji, ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore për shërbimin e IVF-it. Në pikën II të njëjtit vendim i është shqiptuar gjobë në vlerë prej 20,000.00 (njëzet mijë) euro, për shkelje të dispozitave të ligjit për Shëndetësi 04/L-125 dhe UA Nr. 06/2013, me arsyetim se gjatë inspektimit u vërtetua fakti se IPSH “Bahceci Healthcare” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstertrikë & Kirurgji, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, qelizat e dhuruesit janë përdorur-transferuar në 2-7 ferma e jo vetëm në një pacient, siç është e paraparë me UA 06/2013, mungon verifikimi në regjistrin zyrtar për shfrytëzimin e qelizave gjinore të dhuruara në institucionet tjera ku pacientët kanë dhuruar, mungon numri total i embrioneve në dosjet e pacientëve të përfituara me numrin e embrioneve të transferuar të ngrirë dhe të asgjësuar të pacientit, pëlqimi i psikologut, pëlqimi i juristit, nënshkrimi i mjekut, mungon regjistri i posaçëm për donator, mungon sistemi

i kodimit unik nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas, dyshohet se është bërë kompensimi për dhurim të qelizave, dosja e pacientëve të dhuruesve nuk plotësohet me të gjitha të dhënat, mungojnë analizat e obliguara për sëmundjet ngjitëse, anamneza e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut më vulë, përdoret gjuha turke në dosjet e pacientëve dhe vazhdimisht reklamim të FAM-it në rrjetet sociale facebook. Janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 11 par.1 nën par.1.3. dh e1.4, neni 15 par.1.3., neni 19 par1, neni 20 par.3, 31 par. 1 dhe 2, neni 43, neni 24par.3, neni 52 par 1 dhe 2 të UA nr. 06/2013 për frytnimin e asistuar Mjekësore. Për shkak të këtyre shkeljeve inspektorati shëndetësor kërkon nga bordi për Licencim dhe Akreditim në Ministrinë e Shëndetësisë, të bëj revokimin e licencës për shërbimin e IVF-së në afat kohor prej një (1) vit.

17. Nga Pagesë e faturave për pagesë të gjobës, “Bahceci Helthcare” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstertrikë & Kirurgji tani paditës, më datë 03.06.2020 ka bërë përmes transaksionit bankar pagesën e gjobës në shumë totale prej 20,000.00 (njëzet mijë) euro në llogarinë bankare të paditurës Ministria e Shëndetësisë. Inspektorati shëndetësor.
18. Me Aktvendim për pushim te hetimeve PPS.98./20 nr.0038672 më datë 15.09.2021, Prokuroria Speciale-Departamenti për krim të organizuar më datë 15.09.2021 ka marr aktvendim për pushimin e hetimeve ndaj të pandehurve –profesionistëve shëndetësor të FAM-it. “Bahceci Helathcare” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstertrikë & Kirurgji.

Baza Ligjore

19. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor, Neni 1 përcakton Qëllimin e këtij Udhëzimi duke cituar se “Ky udhëzim administrativ rregullon procedurat e frytnimit të asistuar mjekësor, realizimin dhe këshillimin për këto procedura si e drejtë e individit që synon të trajtojë një ose disa shfaqje mjekësore të infertilitetit, në rast kur çifti nuk arrin shtatëzani të dëshiruar me rrugë natyrore. Neni 11 par.1 pika 1.3 përcakton se “ Këshillimi me psikologun klinik i cili obligohet që personat nga par 1.1 ti njoftoj me reaksionet e mundshme psikike për procedurat e FAM dhe të lëshoj raport me shkrim, 1.4, Këshillimi me juristin i cili obligohet nga personat nga nën par. 1.1 ti njoftoj me aspektet juridike për procedurat e FAM dhe të

lëshoj raport me shkrim, Neni 15 par. 1.3 përcakton se “ Personi përgjegjës obligohet të informoj dhuruesin për testet e nevojshme laboratorike”, Neni 20 par. 3 përcakton se “embrionet e mbetura nëse i plotësojnë kriteret cilësore, ruhet për shfrytëzim eventual vetëm te e njëjta femër sipas kushteve të përcaktuara të këtij udhëzimi administrativ, Neni 24 par. 1 përcakton se “Qelizat gjinore të dhuruara nga një person, shfrytëzohen deri në lindjen e më së shumti tre fëmijëve të gjallë, par.2, Ndalohet përdorimi i qelizave gjinore të një dhuruesi te çiftet martesore, çiftet jashtëmartesore dhe te femrat e pa martuara, atëherë kur ato shfrytëzohen për lindjen e më shumë se tre fëmijëve të gjallë. Neni 31 par.1 përcakton se “Institucionet shëndetësore për marrjen dhe ruajtjen e qelizave gjinore, embrioneve obligohen të vendosin dhe përditësojnë sistemin e kualitetit”, par. 2 “Institucioni obligohet ti ndërpres masat e domosdoshme që të siguroj sistemin e kualitetit dhe kontrolli e vazhdueshëm i cili përfshin: procedurën standarde të punës, udhëzime, trajnime, doracak referimi, formularë për raportim, të dhëna për dhuruesin dhe informatë për destinacionin e fundit të qelizave gjinore dhe embrioneve, Neni 43 par 1, përcakton se “Institucioni shëndetësor obligohet që të majë regjistër të dhuruesve të qelizave gjinore”, .

Vlerësimi i gjykatës

20. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit dhe të përfaqësuese së të paditurës në seancë, thënieve në padi nga paditësi dhe përgjigjes në padi, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pasi u konstatua se pretendimi i te paditurës se padi është ushtruar pas afatit është i pabazuar në ndonjë provë, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
21. Gjykata vlerëson se me vendimin e kundërshtuar Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati shëndetësor, ka marr vendim duke i ndaluar “ Bahceci Healthcare” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstertrikë&Kirurgji, ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore për shërbimin e IVF-it. Në pikën II të të njëjtit vendim i është shqiptuar gjobë në vlerë prej 20,000.00 (njëzet mijë) euro, për shkelje të dispozitave të ligjit për Shëndetësi 04/L-125 dhe UA Nr. 06/2013, me arsyetim se gjatë inspektimit u vërtetua fakti se IPSH “Bahceci Healthcare” Spital Special për Gjinekologji dhe

Obstertrikë&Kirurgji, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, qelizat e dhuruesit janë përdorur-transferuar në 2-7 ferma e jo vetëm në një pacient, siç është e paraparë me UA 06/2013, mungon verifikimi në regjistrin zyrtar për shfrytëzimin e qelizave gjinore të dhuruara në institucionet tjera ku pacientët kanë dhuruar, mungon numri total i embrioneve në dosjet e pacientëve të përfituara me numrin e embrioneve të transferuar të ngrirë dhe të asgjësuar të pacientit, pëlqimi i psikologut, pëlqimi i juristit, nënshkrimi i mjekut, mungon regjistri i posaçëm për donator, mungon sistemi i kodimit unik nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas, dyshohet se është bërë kompensimi për dhurim të qelizave, dosja e pacientëve të dhuruesve nuk plotësohet me të gjitha të dhënat, mungojnë analizat e obliguara për sëmundjet ngjitëse, anamneza e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut më vulë, përdoret gjuha turke në dosjet e pacientëve dhe vazhdimisht reklamim të FAM-it në rrjetet sociale facebook. Janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 11 par.1 nën par.1.3. dhe 1.4, neni 15 par.1.3., neni 19 par1, neni 20 par.3, 31 par. 1 dhe 2, neni 43, neni 24par.3, neni 52 par 1 dhe 2 të UA nr. 06/2013 për frytnimin e asistuar Mjekësore. Për shkak të këtyre shkeljeve inspektorati shëndetësor kërkon nga bordi për Licencim dhe Akreditim në Ministrinë e Shëndetësisë, të bëj revokimin e licencës për shërbimin e IVF-së në afat kohor prej një (1) vit.

22. Gjykata rikujton se, Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor, ka për qëllim të rregulloj procedurat e frytnimit të asistuar mjekësor, realizimin dhe këshillimin për këto procedura si e drejtë e individit që synon të trajtojë një ose disa shfaqje mjekësore të infertilitetit, në rast kur çifti nuk arrin shtatëzani të dëshiruar me rrugë natyrore.

23. Në këtë drejtim, Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor ka saktësuar në nenin 24 par.1 se *“Qelizat gjinore të dhuruara nga një person, shfrytëzohen deri në lindjen e më së shumti tre fëmijëve të gjallë, par.2, “Ndalohet përdorimi i qelizave gjinore të një dhuruesi te çiftet martesore, çiftet jashtëmartesore dhe te femrat e pa martuara, atëherë kur ato shfrytëzohen për lindjen e më shumë se tre fëmijëve të gjallë”*, duke rezultuar në atë se kjo dispozitë ligjore në theks të veçante përcakton numrin e lindjes së fëmijëve të gjallë duke theksuar se qelizat gjinore shfrytëzohen deri në lindjen e më së shumti tre fëmijëve të gjallë dhe e

ndalon përdorimin e qelizave gjinore të një dhuruesi të çiftet martesore, çiftet jashtëmartesore dhe të femrat e pa martuara, atëherë kur ato shfrytëzohen për lindjen e më shumë se tre fëmijëve të gjallë.

24. Gjykata gjen se, organi i paditur në vendimin e kundërshtuar gjatë inspektimit ka konstatuar se IPSH "Bahceci Healthcare" Spital Special për Gjinekologji dhe Obstertrikë & Kirurgji, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, qelizat e dhuruesit janë përdorur-transferuar në 2-7 femra e jo vetëm në një pacient, siç është e paraparë në nenin 20 par. 3 i UA 06/2013 përcakton se *"embrionet e mbetura nëse i plotësojnë kriteret cilësore, ruhet për shfrytëzim eventual vetëm të e njëjta femër sipas kushteve të përcaktuara të këtij udhëzimi administrativ*, lidhur me neni 24 par. 1 ku është përcaktuar se *"Qelizat gjinore të dhuruara nga një person, shfrytëzohen deri në lindjen e më së shumti tre fëmijëve të gjallë, par.2, Ndalohet përdorimi i qelizave gjinore të një dhuruesi të çiftet martesore, çiftet jashtëmartesore dhe të femrat e pa martuara, atëherë kur ato shfrytëzohen për lindjen e më shumë se tre fëmijëve të gjallë.*

25. Këtë konstatim paditësi e ka kundërshtuar me arsyetim duke theksuar se e paditura nuk e ka vërtetuar me prova materiale se qelizat janë shfrytëzuar në lindjen e më shumë se tre fëmijëve të gjallë, përdërisa e ndërsa paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë në gjykatë për të vërtetuar të kundërtën. Përdërisa e paditura i referohet dosjeve të pacientëve: dosjes e dhuruesve me nr të. dosjes DNR 30, YD1, YD9, YD5, DNR6 ku u konstatua që nuk janë të evidentuar kujt i janë dhuruar embrionet; Ne dosjen e pacientit me nr. YD5 është bërë tërheqja e 110 qelizave në total nga të cilat 15 janë transferuar mirëpo nuk ka asnjë shenim se ku janë dhuruar keto qeliza tjera, dokumentimi i embrioneve deri në destinacionin e fundit mungon; dosjen e pacientit me nr. YD 9, DNR 56, 48-31 që nga një dhurues janë transferuar qelizat gjinore në 2-7 femra e që 4 prej tyre janë shtatzane në të njëjtën kohë); Neni 24 paragrafi 3 i UA 06/2013 obligon institucionin shëndetësor që para dhurimit të fekondimit heterolog të kërkojë verifikimin në regjistrin zyrtar për shfrytëzimin e qelizave gjinore të dhuruara të cilat duhet të jenë në pajtim me paragrafin 1 dhe 2. Ne dosje të pacientit YD5 ,DNRS28 qëndron se kanë qenë dhurues edhe me herët në IPSH "Lindja", IPSH "Fati im" , IPSH, - e që të gjitha këto dosje janë në posedim dhe në kontroll të paditësit,

paditësi nuk i ka siguruar asnjë provë për gjykatën në mënyrë që gjykata të vërtetoj një gjendje tjetër faktike.

26. Po ashtu në raport Ref 10/Aj-017-19 dhe në vendimin e kundërshtuar me padi i padituri ka konstatuar se gjatë procedurës së inspektimit është vërtetua se paditësit i mungon verifikimi në regjistrin zyrtar për shfrytëzimin e qelizave gjinore të dhuruara në institucionet tjera ku pacientët kanë dhuruar, mungon numri total i embrioneve në dosjet e pacientëve të përfituara me numrin e embrioneve të transferuar të ngrirë dhe të asgjësuar të pacientit, pëlqimi i psikologut, pëlqimi i juristit, nënshkrimi i mjekut, mungon regjistri i posaçëm për donator, mungon sistemi i kodimit unik nga dhuruesi deri te pranuesi dhe anasjelltas, dyshohet se është bërë kompensimi për dhurim të qelizave, dosja e pacientëve të dhuruesve nuk plotësohet me të gjitha të dhënat, mungojnë analizat e obliguara për sëmundjet ngjitëse, anamneza e pacientit si dhe nënshkrimi i mjekut me vulë, përdoret gjuha turke në dosjet e pacientëve, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të UA 06/2013, ndërsa paditësi nuk ka dëshmuar me prova kundërshtimet e tij ndaj vendimit të kundërshtuar me padi.

27. Gjykata konstaton se paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë në gjykatë për ti kundërshtuar konstatimet e të paditues gjatë procesit inspektimit të cilat janë dhënë në raport Ref 10/Aj-017-19 dhe në vendimin e kundërshtuar, siç përcaktohet në nenin 319 të LPK: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta dhe në të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit*, prandaj duke qenë së nga provat a administruara me asnjë provë nuk u vërtetuan pretendimet e paditësit dhe nuk u vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo që pala e paditur ka konstatuar në procedurë administrative.

28. Gjykata vlerësoj edhe Aktvendim për pushim te hetimeve PPS.98./20 nr.0038672 më datë 15.09.2021, Prokuroria Speciale-Departamenti për krim të organizuar më datë 15.09.2021 për pushimin e hetimeve ndaj të pandehurve –profesionistëve shëndetësor të FAM-it. “Bahceci Helathcare” Spital Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë & Kirurgji, por vlerësoj se përgjegjësia penale nuk është kusht për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit në procedurë administrative.

29. Prandaj bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.100/22, datë 29.02.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.